


Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me aftësi të kufizuar




Shënim: Në lidhje me të dhënat për “Përqindja e fëmijëve që kanë braktisur shkollën”, të dhënat primare janë marrë nga Drejtoria Arsimore Rajonale, - Shkodër, 2011 dhe përlogaritja e treguesit në përqindje është bërë nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve.

OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE, QARKU SHKODËR



Qarku i Shkodrës ka një popullsi prej 332.483 banorë¹. Ai përbëhet nga Rrethi Shkodrës, Pukës dhe Malsisë së Madhe, me 33 Komuna dhe Bashki përkatësisht: 5 Bashki dhe 28 Komuna. Qyteti i Shkodrës është qyteti më i rëndësishëm në Qark, i cili është edhe qendra e Prefekturës dhe e Qarkut Shkodër.

Qyteti i Shkodrës është themeluar në shekullin e IV para erës së re nga fisi ilir i Labeatëve. Në kohën kur popullsia ilire e territorit shqiptar kishte arritur zhvillimin me të lartë ekonomik e kulturor, në vitin 181 para erës së re bëhet kryeqendra e mbretërisë ilire. Me ndarjen e Perandorisë Romake, Shkodra, kalon nën kontrollin e Bizantit por vazhdon të varet nga



¹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Mars 2011



Kisha e Romës, meqë ishte një qendër e rëndësishme fetare. Duke përballuar dyndjet e shumta të barbarëve, shekulli XI e XIV, Shkodra përjetoj edhe një periudhë të shkurtër vetëqeverisjeje dhe në pjesën e dytë të shekullit XIV duke qenë kryeqendër e shtetit feudal të Balshajve, para se të kalonte në varësinë e Venedikut në shekullin XV. Në këtë kohë filloi të rikonstruohet kalaja (e cila filloi të ndërtohej në shek. V dhe IV) dhe qyteti merr emrin *Scutari*. Në shek IV në trevat që përbënin më parë principatën e Pultit u formuan ndarje më të vogla etnografike. Këto bashkësi ekonomike shoqërore shkuan drejt përqendrimit në shekujt e më pasme duke marrë emrin e përbashkët *Malësi e Madhe*. Ndërsa rrënjët e krahinës së *Pukës* lidhen me periudha të caktuara historike. Në lashtësi Puka banohej nga banorë të fisit të piruesve dhe si qendër territori ka një histori prej 2000 vjeçare.

Më shumë informacion rreth qarkut mund të gjeni në faqen:



<http://www.qarkushkoder.org>

1 Ibid;

Përshkrim mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Qark:

Përshkrim mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Qark:

Qarku Shkodër është një nga rajonet më të varfra ku përjashtimi social i grupeve në nevojë vë në rrezik shumë të drejta të fëmijëve. Qarku Shkodër ka një popullsi prej 332.483 banorë¹ (2010) dhe një numër të përgjithshëm familjesh prej 96.563², nga të cilat 7.958³ (8.3%) janë familje të varfra dhe me fëmijë (grupmosha 0-15 vjeç). Numri i fëmijëve (0-18 vjeç) është 94.728 ose 28.5 % e popullsisë së përgjithshme.



Në vitin 2010 në Qarkun Shkodër 1 në 5 fëmijë (ose 10,875 fëmijë)⁴ të grupmoshës 6-15 vjeç jetonte në familje që trajtohen me Ndihmë Ekonomike (NE).

Në Qarkun e Shkodrës, për vitin 2010 ishin 1.891 fëmijë të moshës 0-18 vjeç me aftësi të kufizuar (PAK), ose 2 % e fëmijëve në nivel Qarku⁵.

Kategoritë më në nevojë janë: fëmijët jashtë kujdesit prindëror; fëmijët që punojnë; fëmijët me aftësi të kufizuar; fëmijët në gjakmarje; fëmijët në rrezik trafikimi; fëmijët romë etj.

4 Ibid;

5 Burimi: Zyra e "Shërbimit Social Shtetëror" Tiranë, Tetor 2011





Observatori për të drejtat e fëmijës është një strukturë vëzhguese e shoqërisë civile e ngritur në qarkun e Shkodrës në vitin 2009, e cila në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët vendorë publikë e jo-publikë bën mbledhjen sistematike të të dhënave dhe përgatit raporte dhe informacione periodike për aktorët lokalë dhe kombëtarë lidhur me situatën e fëmijëve, shkëlqen e të drejtave, zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe nevojat për përmirësimin e tij të mëtejshëm.

Observatori për të drejtat e Fëmijëve, Qarku Shkodër gjendet në:

Rruga "13 Dhjetori", Godina e Bashkise,
Prane Zyres Rajonale te Avokatit te Popullit
Shkodër, Shqipëri

e-mail: observatori_shk@yahoo.com

URL: www.observator.org.al



Politika Rajonale që ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve

Në qarkun e Shkodrës është hartuar dhe miratuar "*Strategjia Rajonale për të Drejtat e Fëmijëve*" dhe "*Plani i Veprimit 2011-2013*".

Gjithashtu është hartuar edhe "*Analiza e buxhetimit të politikave sociale për fëmijët*" e cila pasqyron gjendjen aktuale, përcakton qartë nevojat dhe prioritetet si dhe masat që duhet të merren konkretisht, në lidhje me zbatimin e të drejtave të fëmijëve në qarkun Shkodër, në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe dokumentave të tjerë të rëndësishëm që mbrojnë të drejtat e fëmijëve në Shqipëri.

	Malësi e Madhe	Pukë	Shkodër
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor ¹	794	544	2963
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin e detyrues ²	5289	3102	22973
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin e mesëm ³	1452	966	6475
Përqindja e fëmijëve që kanë braktisur shkollën ⁴	0.25%	0%	0.29%









Në dobi të realizimit dhe përmbushjes të të drejtave të fëmijëve, në Qarkun Shkodër, veç zyrës së Observatorit, është ngritur dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Fëmijëve" në Qark.

1. Burimi: Drejtoria Arsimore Rajonale, - Shkodër (Tetor 2011)

2. Ibid;

3. Ibid;

4. Të dhënat primare janë marrë nga Drejtoria Arsimore Rajonale, - Shkodër, 2011 dhe përlogaritja e treguesit në përqindje është bërë nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve



Shënim: Të dhënat “Përqindja e fëmijëve që jetojnë pa ujë të përmirësuar të pijshëm, energji elektrike, që jetojnë në banesa të papërshtatshme dhe përqindja e fëmijëve me 1 ose 2 prindër të pa punë”, - janë marrë nga studimi i thelluar me autorë A. Ceni dhe V. Kolpeja.